



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 105/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2017 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Kthella” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë”.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Kthella” sh.p.k.
Rr. “Bulevardi Skënderbeg”, pas Kinema Millenium, Shkodër

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Korçë
Rruga “28 Nëntori”, Korçë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.10.2016, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “*Qendra e kreativitetit*”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 07.11.2016, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët pas korrigjimit të ofertave nga autoriteti kontraktor, rezultojnë se kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k.
& “Kthella” sh.p.k. 73.154.761 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Elira” sh.p.k.
& “Beladi” sh.p.k. 74.390.011 lekë, skualifikuar

- | | |
|---|-----------------------------------|
| 3. “Boshnjaku B” sh.p.k. | 75.737.090 lekë, kualifikuar |
| 4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xhengo” sh.p.k.
& “G.P.G. Company” sh.p.k. | 87.120.120 lekë, skualifikuar |
| 5. “Piennis” sh.p.k. | 88.518.492 lekë, skualifikuar |
| 6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” sh.p.k.
& “Agri Konstruksion” sh.p.k. | 90.000.000 lekë, skualifikuar |
| 7. “Alko Impex General Construction” d.sh.h. | 92.192.075 lekë, kualifikuar |
| 8. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Glavenica” sh.p.k.
& “Ngracan” sh.p.k. & “Dajti Park” sh.p.k. | 93.773.232 lekë, skualifikuar |
| 9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k.
& “Vllaznia Ndërtim IS” sh.p.k. | 98.959.712 lekë, skualifikuar |
| 10. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ad - Star” sh.p.k.
& “Murati” sh.p.k. | 96.410.610 lekë, skualifikuar |
| 11. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” sh.p.k.
& “Everest” sh.p.k. | 100.986.324 lekë, skualifikuar |
| 12. “Aurora Konstruksion” sh.p.k. | 97.212.851 lekë, skualifikuar |
| 13. “Junik Konstruksion” sh.p.k. | 104.500.542 lekë, kualifikuar |
| 14. Subjekti fizik “Syrja Bame” | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 21.12.2016 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

Në preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor rezultoi se në pjesën e pajisjeve nuk ka zërin e TVSH-së. Ky zë është vendosur vetëm tek pjesa që ka të bëjë me punimet e ndërtimit. Për sa kohë që në preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor nuk parashikohet TVSH për pajisjet, ajo nuk mund dhe nuk duhet të reflektohet në formularin e ofertës dhe për më tepër të shtohet si zë nga ofertuesi me iniciativën e vet. Preventivi i shpallur nga autoriteti kontraktor nuk mund të modifikohet nga ofertuesit. Mbështetur në sa më sipër janë bërë korrigjimet përkatëse duke mbledhur nëntotalet e shënuara në preventiv, nga ku rezultoi se vlera e ofertës të paraqitur është 73,154,761 lek pa tvsh dhe jo 69,180,462 lek, pa tvsh, siç është shënuar në formularin e ofertës të paraqitur nga ofertuesi. Bazuar në VKM nr 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

II.4. Në datën 27.12.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

[...]

Në datën 21.12.2016 njoftohemi nëpërmjet mesazhit elektronik në llogarinë tonë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik me vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të Bashkisë Korçë. Ky vendim bën vlerësimin e procedurës, kuotimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe na skualifikon ne si operator ekonomik nga procedura e mëtejshme:

Pa dhënë asnjë arsye skualifikimi

Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakte që ekzistojnë. Është një vlerësim dhe një kuotim i cili na skualifikon pa asnjë arsye, në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko-ligjore, sipas të gjitha kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Me kuotimin për vlerësimin e procedurës nuk na ka ardhur fare arsyeja e skualifikimit, madje nuk ka ardhur fare as rubrika poshtë kuotimit ku mund të përcaktohen arsyet e skualifikimit.

Të ndodhur në këto kushte ne sqarojmë se me këtë kuotim jo vetëm që po bëhet një padrejtësi e hapur ndaj subjektit tonë, por nga ana tjetër po i shkaktohet një dëm ekonomik relativisht i madh buxhetit të shtetit.

Nga verifikimi i ofertës tonë e cila rezultoi të jetë më e ulëta, me atë që është eventualisht fituese (më e ulëta e kualifikuar) ka një diferencë afro 26 milion lekë të vjetra. Dëm ky shumë i madh që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit. Jo vetëm në diferencë po edhe në faktin se jemi skualifikuar pa asnjë arsye.

Prandaj paraqesim këtë ankesë pranë jush.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fituese shoqëria Nika sh.p.k.

Në rast të kundërt jemi të detyruar tu drejtohem organeve më të larta administrative dhe gjyqësore për të vënë në vend të drejtat e shkelura në lidhje me barazinë në tendera. Gjithashtu edhe organeve të prokurorisë për të marrë masa ndëshkuese ndaj shkelësve të këtyre të drejtave.

II.5. Në datën 05.01.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 6798/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë:

[...]

Sipas procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezultoi se shoqëria Nika sh.p.k. është skualifikuar për arsyet [...].

Për sa më sipër, pretendimi se shoqëria Nika shpk është skualifikuar nga KVO pa dhënë asnjë arsye skualifikimi nuk qëndron.

Nga informacioni i dhënë nga njësisia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave në kohën kur është bërë vlerësimi elektronik i procedurës ka patur probleme me sistemin çka kish sjellë vështirësi në vlerësimin elektronik të kësaj procedure.

Nga kontrolli i vlerësimit të bërë në sistem nga anëtarët e KVO për shoqërinë Nika shpk rezultoi se është pasqyruar vlerësimi i katër nga pesë anëtarë që ka komisioni. Për sa kohë që ky vlerësim është bërë dhe rezultoi në sistem rrjedhimisht duhej ti kishte shkuar edhe shoqërisë Nika shpk.

Duke qenë se ekziston mundësia që për shkak të defekteve teknike (problemeve me faqen apo me internetin) arsyet e skualifikimit të mos i kenë shkuar operatorit ekonomik, me qëllim që edhe anëtari i pestë të pasqyrojë vlerësimin e tij në sistem dhe për ti garantuar operatorit ekonomik të realizojë të drejtat e tij sipas ligjit duhet të bëhet rivlerësimi i procedurës në sistem sipas vendimit të marrë nga KVO.

II.6. Në datën 13.01.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si më poshtë:

[...]

Më datë 05.01.2017 kemi marrë përgjigje nga titullari i AK i cili na kthen përgjigje për ankimimin tonë dhe e vlerëson si të drejtë vendimin e KVO –së, pasi sipas tyre ka një gabim aritmetik në ofertë, që ka të bëjë me vlerën e TVSH së pajisjeve. Ky gabim aritmetik është më i madh se 2% e vlerës totale të ofertës dhe rrjedhimisht oferta nuk duhet pranuar.

[...]

Pretendimi i AK nuk qëndron pasi ne kemi paraqitur një ofertë totale prej 83.06.555 lekë e ndarë në vlerën pa tvsh 69.180.462 lekë pa tvsh dhe 13.836.093 lekë vlera e tvsh.

Pretendimi i KVO dhe titullarit është se po të mblidhen nëntotalet oferta nuk ka një vlerë prej 69.180.462 lekë pa tvsh por 73.154.761 lekë pa tvsh gjë që do të thotë se ka një gabim aritmetik në vlerë më të madhe se 2% dhe nuk mund të korrigjohet.

*Në fakt e vërteta nuk është kështu siç pretendohet nga KVO, por sqarojmë se preventivi i paraqitur nuk ka asnjë gabim aritmetik dhe vlera totale e tij është në shumë 83.016.555 lekë me tvsh. Vlerë kjo e cila nuk ka asnjë gabim në veprimet aritmetike. Ne kemi paraqitur një sqarim të shënuar në pjesën e jashtme të preventivit duke theksuar se çmimet e vendosura në preventive për pajisje janë çmime të cilët e kanë tvsh të përfshirë. Vlera e paraqitur në preventive për shumën totale II tek e cila supozohet të jetë gabimi, është 23.845.790 lekë e cila është një vlerë e saktë, theksojmë se ne tek pjesa e sqarimit e cila ndodhet në pjesën e fundit të preventivit jashtë saj ne e kemi paraqitur në shumën 19.871.491 lekë të cilës i kemi zbritur $19.871.491 * 20\% = 3.974.298$ lekë. Diferenca e cila është pjesë tvsh $23.845.790 - 19.871.491$ lekë është e barabartë me 20 % e pajisjeve 3.974.298 lekë.*

Kjo shumë 3.974.298 është kaluar në rubrikën e tvsh e cila është në total 13.836.093 lekë. Ky veprim është një sqarim në lidhje me TVSh e pajisjeve të cilën ne e blejmë me tvsh dhe jemi të detyruar ti faturojmë me tvsh për efekt të tatimeve. Ky veprim nuk paraqet asnjë ndryshim në ofertën totale të paraqitur nga ana jonë në vlerën 83.06.555 lekë dhe autoriteti kontraktor nuk ka asnjë ndikim financiar për detyrimet e preventivit.

Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fitues shoqëria Nika shpk.

[...]

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 236/1 prot., datë 23.01.2017, të protokolluar me tonën në datën 27.01.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *arsyeja e skualifikimit Në preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor rezulton se në pjesën e pajisjeve nuk ka zërin e TVSH-së. Ky zë është vendosur vetëm tek pjesa që ka të bëjë me punimet e ndërtimit. Për sa kohë që në preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor nuk parashikohet TVSH për pajisjet, ajo nuk mund dhe nuk duhet të reflektohet në formularin e ofertës dhe për më tepër të shtohet si zë nga ofertuesi me iniciativën e vet. Preventivi i shpallur nga autoriteti kontraktor nuk mund të modifikohet nga ofertuesit. Mbështetur në sa më sipër janë bërë korrigjimet përkatëse duke mbledhur nëntoatet e shënuara në preventiv, nga ku rezultoi se vlera e ofertës të paraqitur është 73,154,761 lek pa tvsh dhe jo 69,180,462 lek, pa tvsh, siç është shënuar në formularin e ofertës të paraqitur nga ofertuesi. Bazuar në VKM nr 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 13 Preventivat e punimeve, është përcaktuar si më poshtë:

Sipas preventivit që gjendet bashkëngjitur dokumenteve standarte të tenderit.

Gjithashtu në dokumentat e tenderit, është ngarkuar preventivi përkatës për këtë procedurë prokurimi, ku janë përcaktuar zërat në kapituj e nënkapituj sipas punimeve të domosdoshme për këtë objekt prokurimi.

III.1.3. Referuar preventivit memec të publikuar nga autoriteti kontraktor konstatohet se janë përcaktuar si më poshtë:

1. *Punime prishje (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 1
2. *Punime dheu (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 2
3. *Punime Betoni e Beton armeje (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 3
4. *Punime murature (me nënzërat e tij)*
Shuma 4
5. *Punime shtresash (me nënzërat e tij)*
Shuma 5
6. *Punime suvatimi, veshje e bojatisjeje (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 6
7. *Punime tarrace dhe h/izolimi (me nënzërat e tij)*
[...]

- Shuma 7*
8. *Punime dyer dritare (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 8
9. *Punime sistemi dhe punime të ndryshme (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 9
10. *Sistemi i furnizimit me ujë + pajisje H/S, furnizimi me ujë nga rrjeti (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 10
11. *Sistemi i shkarkimit të ujërave të zeza (kanalizimet) (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 11
12. *Mbrojtja ndaj zjarit MNZ (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma 12
13. A. *Ngrohja e ambienteve (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma A
B. *Ventilimi (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma B
Shuma 13
14. *Instalimet elektrike*
A - *Furnizimi me tension të ulët (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma A
B – *sistemi i ndriçimit (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma B
C- *Sistemi i mbrojtjes nga mbishkarkimet atmosferike dhe tokëzimi (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma C
D- *Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma D
E – *Rrjeti Data Telefoni (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma E
F- *Sistemi i video survejimit (me nënzërat e tij)*
[...]
Shuma F
G- *Voice evacuation system (me nënzërat e tij)*
[...]



Shuma G
Shuma A-B-C-D-E-F-G
Shuma (I-14)
Fond Rezervë 5.0%
Shuma
TVSH 20%
Shuma totale I

- A. Furnizim pajisje hidraulike (me nënzërat e tij)
[...]
Shuma A
- B. Furnizim pajisje ngrohje (me nënzërat e tij)
[...]
Shuma B
- C. Furnizim pajisje elektrike (me nënzërat e tij)
[...]
Shuma C
- D. Mobilimi (me nënzërat e tij)
[...]
Shuma D

Shuma Totale II (A + B + C + D)
Shuma Totale I + II

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

III.1.3. Në nenin 53, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Operatori ekonomik ankimues, në ankesën e paraqitur Komisionit të Prokurimit Publik, argumenton se: “[...] Më datë 05.01.2017 kemi marrë përgjigje nga titullari i AK i cili na kthen përgjigje për ankimimin tonë dhe e vlerëson si të drejtë vendimin e KVO –së, pasi sipas tyre ka një gabim aritmetik në ofertë, që ka të bëjë me vlerën e TVSH së pajisjeve. Ky gabim aritmetik është më i madh se 2% e vlerës totale të ofertës dhe rrjedhimisht oferta nuk duhet pranuar.

[...]

Pretendimi i AK nuk qëndron pasi ne kemi paraqitur një ofertë totale prej 83.06.555 lekë e ndarë në vlerën pa tvsh 69.180.462 lekë pa tvsh dhe 13.836.093 lekë vlera e tvsh.

Pretendimi i KVO dhe titullarit është se po të mblidhen nëntotalet oferta nuk ka një vlerë prej 69.180.462 lekë pa tvsh por 73.154.761 lekë pa tvsh gjë që do të thotë se ka një gabim aritmetik në vlerë më të madhe se 2% dhe nuk mund të korrigjohet.

*Në fakt e vërteta nuk është kështu siç pretendohet nga KVO, por sqarojmë se preventivi i paraqitur nuk ka asnjë gabim aritmetik dhe vlera totale e tij është në shumë 83.016.555 lekë me tvsh. Vlerë kjo e cila nuk ka asnjë gabim në veprimet aritmetike. Ne kemi paraqitur një sqarim të shënuar në pjesën e jashtme të preventivit duke theksuar se çmimet e vendosura në preventive për pajisje janë çmime të cilët e kanë tvsh të përfshirë. Vlera e paraqitur në preventive për shumën totale II tek e cila supozohet të jetë gabimi, është 23.845.790 lekë e cila është një vlerë e saktë, theksojmë se ne tek pjesa e sqarimit e cila ndodhet në pjesën e fundit të preventivit jashtë saj ne e kemi paraqitur në shumën 19.871.491 lekë të cilës i kemi zbritur $19.871.491 * 20\% = 3.974.298$ lekë. Diferenca e cila është pjesë tvsh $23.845.790 - 19.871.491$ lekë është e barabartë me 20 % e pajisjeve 3.974.298 lekë.*

Kjo shumë 3.974.298 është kaluar në rubrikën e tvsh e cila është në total 13.836.093 lekë. Ky veprim është një sqarim në lidhje me TVSH e pajisjeve të cilën ne e blejmë me tvsh dhe jemi të detyruar ti faturojmë me tvsh për efekt të tatimeve. Ky veprim nuk paraqet asnjë ndryshim në ofertën totale të paraqitur nga ana jonë në vlerën 83.06.555 lekë dhe autoriteti kontraktor nuk ka asnjë ndikim financiar për detyrimet e preventivit.

Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fitues shoqëria Nika shpk.

[...]

III.1.5. Nga informacioni dhe dokumentacioni i depozituar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka argumentuar: “[...] në preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor rezulton se në pjesën e pajisjeve nuk ka zërin e TVSH-së. Ky zë është vendosur vetëm tek pjesa që ka të bëjë me punimet e ndërtimit. Për sa kohë që në preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor nuk përfshihet TVSH për pajisjet, ajo nuk mund dhe nuk duhet të reflektohet në formularin e ofertës dhe për më tepër të shtohet si zë nga ofertuesi me iniciativën e vet. Preventivi i shpallur nga autoriteti kontraktor nuk mund të modifikohet nga ofertuesit.

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike për gabime aritmetike dhe mbështetur në sa më sipër, janë bërë korrigjimet përkatëse duke mbledhur nëntotalet e shënuara në preventiv, nga ku rezultoi se vlera e ofertës të paraqitur është 73.154.761 lekë pa tvsh dhe jo 69.180.462 lekë pa tvsh, siç është shënuar në formularin e ofertës të paraqitur nga ofertuesi. Bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

*III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se është paraqitur dokumenti me emërtimin *Formular oferte Korça*, ku evidentohet se janë përshkruar dhe hartuar zërat sipas preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ku konstatohet si më poshtë:*

Çmimi total i ofertës 69.180.462 pa TVSH; Çmimi total i ofertës 83.016.555 me TVSH.

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga ankimuesi, nga përlogaritjet e kryera, rezulton se, oferta e paraqitur, pas korigjimit të veprimeve duhet të jetë në vlerën totale pa tvsh 73.154.761 lekë. Referuar nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet shprehimisht: “Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar[...].”, nga veprimet aritmetike të kryera të të gjithë preventivit të paraqitur, rezulton se oferta e operatorit ekonomik ankimues ka gabime aritmetike, pas mbledhjes së nëntotaleve të përcaktuara në preventiv, gabime këto që tejkalojnë vlerën 2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar nga ky i fundit.

Në këto kushte, bazuar në përcaktimin ligjor si më sipër cituar, meqenëse gabimet janë më të larta se 2 % e vlerës së ofruar, gjykojmë se oferta ekonomike e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Kthella” sh.p.k. refuzohet menjëherë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Akoma më tej, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues është ankuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor me arsyetimin se në sistemin e prokurimeve elektronike nuk janë dhënë shkaqet e skualifikimit të tij, por thjesht rezulton i skualifikuar. Pas ankesës pranë autoritetit kontraktor, ky i fundit argumenton se “[...] Nga kontrolli i vlerësimit të bërë në sistem nga anëtarët e KVO për shoqërinë Nika shpk rezultoi se është pasqyruar vlerësimi i katër nga pesë anëtarë që ka komisioni. Për sa kohë që ky vlerësim është bërë dhe rezulton në sistem rrjedhimisht duhej ti kishte shkuar edhe shoqërisë Nika shpk.

Duke qenë se ekziston mundësia që për shkak të defekteve teknike (problemeve me faqen apo me internetin) arsyet e skualifikimit të mos i kenë shkuar operatorit ekonomik, me qëllim që edhe anëtari i pestë të pasqyrojë vlerësimin e tij në sistem dhe për ti garantuar operatorit ekonomik të realizojë të drejtat e tij sipas ligjit duhet të bëhet rivlerësimi i procedurës në sistem sipas vendimit të marrë nga KVO.

Rezulton se, pas njohjes me arsyet e skualifikimit, operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur një ankesë pranë autoritetit kontraktor, për të ankimuar tashmë shkaqet e skualifikimit pas njohjes së tyre, në respekt të shkallëve të ankimimit. Konstatohet se operatori ekonomik ankimues shkaqet e skualifikimit i ka ankimuar vetëm në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 63, pika 1, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji[...].

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Kthella” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 64 Protokoll

Datë 13.01.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha